

*amnesty international*

REPUBLIKA FEDERALE E  
**JUGOSLLAVISË**

***KRIZA E TË DREJTAVE TË  
NJERIUT NË KRAHINËN E  
KOSOVËS***



**Seria e Dokumentave A: Ngjarjet deri me  
Qershor 1998**

**#4: Gjykime e padrejta  
dhe abuzime të  
proceseve në vijim**

Publike  
AI Index: EUR 70/35/98/ALB

**QERSHOR 1998**



## Rreth dokumenteve kësaj serie

Prej qershorit 1998, Bashkësia Ndërkombëtare po shikon derisa situata e sigurisë në krahinën e Kosovës të Republikës Federale të Jugosllavisë po keqësohet me shpejtësi dhe madje edhe respekti minimal për të drejtat e njeriut është zvogëluar. Operacionet e fundit ushtarako-policore serbe, edhe pse nga larg duken të drejtuara kundër opozitës së armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ato përsëri kanë sjellur në vdekjen e qindra civilëve, prej të cilëve shumë janë dukshëm rezultat i sulmeve të qëllimta dhe pa dallim. Sulmet mbi civilët kanë qenë një nga arsyet pse mijëra njerëz janë larguar nga shtëpitë e tyre. Anëtarët e UÇK-së kanë qenë gjithashtu përgjegjës për keqpërdorimin e të drejtave të njeriut.

Zhvillimet e qershorit të vitit 1998 nuk mund të izoloohen nga shkeljet e shumta të drejtave të njeriut që në Kosovë ndodhin prej më shumë se një dekadë. Gjatë gjithë kësaj kohe Amnesti Interneshënëll ka dokumentuar dhe ka berë fushatë kundër modelit sistematik të dhunimit të drejtave të njeriut në krahinën e Kosovës; përfshirë ketu torturën dhe keqtrajtimin nga policia, vdekjet gjatë arrestimeve nga policia dhe gjykimet e padrejta të burgosurve politik. Mungesa e zgjidhjes së duhur të këtyre problemeve si dhe shkeljet tjera të të drejtave themelore të njeriut në krahinë duhet të numërohen si burime të frustrimeve dhe dëshprimit që ka kulminuar deri në konfliktin e tanishëm.

Përveç studimeve të vazhdueshme, punës me mediat, iniciativave e fushatave të anëtarëve të saj në gjithë botën, Amnesti Interneshënëll, për t'iu përgjigjur ngjarjeve të qershorit 1998, në serinë e raportimeve të saj hulumton përtej titujve të lajmeve ditore dhe vazhdon shqyrtimin e saj të hollësishëm dhe në detaje të modeleve të dhunës shumëvjeçare në krahinën e Kosovës. Në këtë seri janë publikuar njëkohësisht katër dokumente:

**#1: *Hyrje: Kriza që pritej të ndodhte (AI Index: EUR 70/32/98/ALB).*** Një analizë e përmbledhur e shkaqeve të krizës së sotme dhe rekomandimet që i bën Amnesti Interneshënëll komunitetit ndërkombëtar, autoriteteve jugosllave dhe UÇK-së.

**#2: *Dhuna në Drenicë (AI Index: EUR 70/33/98/ALB).*** Një analizë e hollësishme e vrasjeve arbitrare dhe ekzekutimeve pa gjykim gjatë operacioneve policore dhe ushtarake në periudhën shkurt-mars 1998 në zonën e Drenicës (para ngjarjeve të qershorit) dhe raportimet e keqpërdorimit të drejtave të njeriut nga UÇK-ja.

**#3: *Vdekjet gjatë arrestimeve, tortura dhe keqtrajtimi (AI Index: EUR 70/34/98/ALB).*** Një vëzhgim i përdorimit të gjërë të torturës dhe keqtrajtimit ndaj të arrestuarve dhe demonstruesve në rrugë përfshirë ketu edhe dëshmitë e hollësishme të viktimave të fundit të arrestit, si dhe dëshmitë fotografike gjatë vitit 1998.

**#4: *Gjykimet e padrejta dhe abuzime të proceseve në vijim (AI Index: EUR 70/35/98/ALB).*** Një vëzhgim i dështimeve të vazhdueshme në administratën e drejtësisë gjatë rasteve politike, duke përfshirë këtu edhe hollësitë e katër gjykimeve politike gjatë viteve 1997-98.

Keto raportime janë bazuar kryesisht në informacionin e mbledhur gjatë një mision të Amnesti Interneshënëll në Republikën Federale të Jugosllavisë në mars të vitit 1998 për të hetuar shkeljet e drejtave të njeriut duke përfshirë këtu edhe ato të kryera në kontekstin e operacioneve policore dhe ushtarake në zonën e Drenicës dhe mbi informacionin e fundit të marrë prej përfaqësuesve të Amnesti Interneshënëll në teren gjatë qershorit 1998. Gjithashtu informatat janë marrë edhe nga vëzhguesit lokal të drejtave të njeriut në Kosovë dhe Beograd, nga juristët vendas, gazetarët e huaj dhe vendas dhe individët të tjerë. Amnesti Interneshënëll është mirënjohëse për ndihmën që i është ofruar nga këto burime.

Seritë e mëtejshme të raportimeve që janë duke u përgatitur do të shqyrtojnë situatën e drejtave të njeriut në Kosovë prej qershorit të vitit 1998.

***Fotografia në kopërtinë*** : Besim Rama dhe të akuzuarit e tjere në gjyqin e tyre, korrik 1997 (shih këtë dokument, faqe 6). © Rilindja.

REPUBLIKA FEDERALE E  
**JUGOSLLAVISË**

*Kriza e të Drejtave të Njeriut në Krahinën e  
Kosovës*

## Gjykimet e padrejta dhe abuzime të proceseve në vijim

### **Hyrje**

Autoritetet serbe kanë deshtuar vazhdimisht në sigurimin e gjyqëve të drejta për rastet politike.

Rreth 34 persona u dënuan dhe u burgosën në tri gjyqe kryesorë politike në vitin 1997 dhe 16 të tjerë u dënuan në *mungesë* në gjyqet e njëjta. Shumë procedura gjyqësorë për raste të tilla janë në proces e për vitin 1998 dhe mund të jetë që shumë gjyqe të tjera politike të padrejta do të vinë më vonë.

Rastet e torturave dhe keqtrajtimit të përshkruara në dokumentin shoqëruar të këtij raporti ilustronjë se çfarë ju ka ndodhur shumicës së viktimave si atyre që janë keqtrajtuar jashtë murëve të stacioneve të policisë ose të burgosur apo të mbajtur nga policia periudhë të shkurtër kohorë (shihni *Vdekjet gjatë arrëtimeve, torturat dhe keqtrajtimet*, dokumenti #3 në këtë seri, AI Index: EUR 70/34/98/ALB). Pasojat për ata që kanë qënë arrëstuar dhe akuzuar në periudha të gjata mund të ketë qënë më serioze: viktimat janë shtrënguar që të bejnë deklaratë duke ngarkuar me faj vetveten ose të tjerët, deklaratë kato që janë pranuar menjëherë si prova gjatë

gjyqimit të tyre<sup>1</sup>. Amnesty interneshënëll është gjithashtu e shqëtësuar raportimeve të shkeljeve të shumta të Kodit Federal të Procedurës Pënale (KPP) dhe standardeve ndërkombtarë, ku viktimat janë arrëstuar dhe burgosur në mënyrë arbitrare pa proces vazhdues, përfshirë ketu edhe shkeljen e të drejtës se tyre për të komunikuar lirisht me avokatin mbrojtës.

### **Gjendja në ligjit**

Dënimet e aplikuara në raste politike kunder shqiptarëve etnik zakonisht bazohen në Kodin e Federal të Krimin, që përjashton mundësinë e dënimit me vdekje, duke e

---

<sup>1</sup>Kjo praktikë është në kundërshtim me Artikullin 15 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës që kërkon “që çdo deklaratë e berë si pasojë e torturës nuk mund të përdoret si provë në procedurat gjyqësore, përveç kundër një personi të akuzuar për torturë si provë për dhënien e deklaratës.” Me tutje, Raportuesi i Veçantë i Kombeve të Bashkuara për Torturë ka theksuar rolin e gjyqëtarit në sigurimin e respektimit të këtij rregulli duke parandaluar keshtu torturën. (EICN. 4/1992/17, faqe 103, paragrafi 280).

zëvendësuar atë me maksimumin, 20 vjet burg. Dënimi me vdekje është i mundshëm për “vrasje të rënda” sipas ligjit serb të Kodit të Krimit, edhe pse Amnesti Interneshënell nuk di ndonjë rast ku shqiptarët etnik të janë dënuar me vdekje. Dy serbe, **Dejan Andjelković** dhe **Zlatan Zakiq**, u dënuan me vdekje në mars të vitit 1998 për vrasjen e paramenduar të katër anëtarëve të familjes Cako në Prizren në vitin 1993. Asnjë ekzekutim nuk është bërë në Serbi qysh më 1992.

Në Artikullin 196, KPP specifikon që policia mund të mbajë të arrestuar të dyshimtit deri në tre ditë dhe vetëm në raste të veçanta si për qëllim të verifikimit të alibive; arrestimi në polici nuk duhet të jetë pjesë e zakonshme e procesit gjyqësor. Policisë normalisht i kerkohet të dorëzojë të dyshimtin tek gjykatësi hetues që do të mbikqyrë hetimet ndërkohë që i dyshimti mbahet në burg për hetime. Standardet ndërkombetare si Grupi i Kombeve të Bashkuara i Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nën çfarëdo Forme Arrëstim apo Burgosje, specifikojnë që një i burgosur duhet të lejohet të komunikojë lirish me këshilltarin e tij/saj legal dhe kjo e drejtë mund të ndalohej vetëm në raste të veçanta dhe atë vetëm për disa ditë. Keto të drejta janë vendosur si masë sigurie kundër torturës ose keqtrajtimit dhe për të siguruar gjyqë të drejta. Megjithatë, KPP-ja nuk garanton këtë të drejtë derisa të arrestuarit janë nën hetim policor, pavarësisht nga fakti se, si Kushtetuta Federale dhe ajo Serbe (respektivisht Artikujt 29 dhe 24) specifikojnë që “gjithkush ka të drejtë të merret në pyetje në praninë e avokatit mbrojtës që e zgjedh vetë”

## Gjendja në praktikë

Si rutinë KPP-ja shkelet. Të dyshimtit mbahen për tri ditë dhe shpesh shumë më gjatë pa u përcjellur në duar të gjykatësit hetues. Avokatët mbrojtës bejnë të ditur se policia gjithashtu vazhdon t’i marrë në pyetje të arrestuarit edhe pas transferimit të tyre në burgjet e hetuesisë. Është për t’u shqetësuar pasi pikërisht gjatë kësaj periudhe ndodhin keqtrajtimet e policisë; në rastet e atyre të dyshimtit për krime serioze si për shembull terrorizëm, kjo e rrit masën e torturës për të nxjerrë deklaratave me dhunë. Duke mos pasur kontakt me avokatët, të burgosurit nuk kanë mundësi të marrin “ndihmën e nevojshme të një eksperti” për t’u ankuar kundër arrestimit sipas Artikullit 196 të KPP. Ajo çka është edhe më serioze është se Artikujt 10 dhe 218, paragrafi 8 të KPP-së, që ndalojnë nxjerrjen e deklaratave në mënyrë të dhunshme ose nëpërmes kërcënimeve ndaj të dyshimtit apo dëshmitarëve, si rutinë injorohen gjatë proceseve hetuese.

Të dyshimtit mbahen kështu të arrestuar pa asnjë mundësi për të kontaktuar avokatët, familjet apo mjekët për ditë të tëra ose disa herë me javë, derisa policia i heton ata duke përdorur metoda të ndryshme të torturave me qëllim që t’i detyrojë të nënshkruajnë “rrëfimet” duke akuzuar me këto të fundit vetveten dhe të tjerët. Format e torturave dhe keqtrajtimit përfshijnë kombinimet e rrahjeve me grushta, shkopat policie, tuba apo objekte të tjera të rënda. Në disa raste shkopat e shokut elektrik janë përdorur se bashku gjatë rrahjes. Shpesh është raportuar se policia ka përdorur shkopinjtë e shokut elektrik për të minimizuar çdo shenjë të dukshme të torturës apo

keqtrajtimit që nga ana tjetër do të dukeshin si rezultat i të rrahurave ose strësit të ngjashëm fizik.

Edhe pas transferimit në burgje të hetuesisë avokatëve mbrojtës normalisht ju mohohet e drejta dhe mundësia për të komunikuar lirisht dhe privatisht me klientet e tyre siç kërkohet nga Grupi i Parimeve dhe Komenti i Përgjithshëm i Komitetit të Drejtave të Njeriut të KB në Artikullin 14 (3) të Konventës Ndërkombëtare mbi Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)<sup>2</sup>. KPP-ja i lejon gjykatësit hetues të kufizojnë komunikimin mes atyre që kërkojnë mbrojtje dhe avokatëve mbrojtës para se të leshohet akt-padia, ose hetimi është kryer, pa kurfarë kontrole dhe baraspeshe mbi këtë ketë kufizim (Artikulli 74). Në praktikë atyre që kërkojnë mbrojtje shpesh i'u refuzohet komunikimi i lirë edhe pas lëshimit të akt-padise.

## **Gjyqjet e padrejta të vitit 1997**

Brengosjet e përshkruara me lartë janë të

---

<sup>2</sup>Në Komentin e saj të Përgjithshëm 13 (Artikulli 14, seksioni njëzetentë, 1984) Komiteti për të Drejtat e Njeriut deklaroi që 14(3) (b) i KNDCP... "kërkon këshilltarët të komunikojnë me të akuzuarit me kusht që të respektohet sekretin e komunikimit. Avokatët duhet të jenë në gjendje të këshillojnë dhe të paraqesin klientet e tyre në përputhje me standardet dhe vlerësimet e formuara profesionale pa asnjë kufizim, influencë, presion apo ndërhyrje nga ndonjë palë" (HRI/GEN/1, faqe 15, paragrafi 9).

ilustruara nëpërmjet tre gjyqjeve politike që u mbajtën në vitin 1997. Në mes tetorit 1996 dhe shkurtit 1997 policia serbe arrestoi se paku 100 vetë në lidhje me hetimet ndaj sulmeve të armatosura kundër policisë serbe dhe civilëve gjatë vitit 1996. Numri me i madh i arrestimeve u bë në Janar të vitit 1997.

Disa nga të arrestuarit u mbajtën të mbyllur, pa mundësi të komunikimit për shumë ditë: **Besim Rama** dhe **Avni Nura** u arrestuan nga policia më 17 shtator të vitit 1996, por përkundër përpjekjeve të vazhdueshme, familja dhe avokatët mbrojtës, deri në fillim të tetorit, nuk ishin në gjendje të merrnin informacion se ndodheshin. Pastaj, në fillim të tetorit, së paku 13 ditë pas hetimit nga policia, gjatë së cilës kohë ata deklaruan se ishin torturuar, u morrën në pyetje nga gjykatësit e hetuesisë. Në akt padinë, ishte shënuar se arrestimi i tyre kishte filluar më 29 shtator. Avokatët e tyre nuk u lejuan të ishin të pranishëm gjatë këtij hetimi. Vetëm më 8 Tetor, avokatët patën mundësi t'i shohin klientët e tyre, por nuk ishin në gjendje të flisnin lirisht dhe të diskutonin akuzat kundër tyre. Në veçanti vellau i **Besim Ramës**, **Osman Rama**, pohoi se ishte rrëmbyer në një makinë nga oficerë të policisë dhe ishte shpjer në një vend të panjohur ku ishte rrahur dhe marrë në pyetje për aktivitetet politike të Besimit. Ai u lirua dhe u arrestua përsëri për gjashtë ditë të tjera hetimesh gjatë të cilave u torturua para se të lirohej.

Në janar dhe shkurt të vitit 1997 ndodhi një valë e re arrestimesh ku u arrestuan se paku 100 veta. Tridhjetë e pesë prej tyre u gjykuan më pas dhe dy, **Besnik Restelica** dhe **Jonuz Zeneli** vdiqën gjatë hetimeve (për informacion të metëjshëm

për vdekjen e Jonuz Zenelit shih dokumentin shoqërues, *Vdekje gjatë arrestimeve, tortura dhe keqtrajtimi, #3* në këtë seri, AI Index: Eur 70/34/98/ALB). Ka pasur raportime që shumica kanë qenë torturuar apo keqtrajtuar gjatë arrestimit dhe hetimit. Një nga rastet me të rënda është ai i **Nait Hasanit** që u arrestua më 28 Janar 1997. Më 29 Janar ai u transferua nga policia në një spital, në Prishtinë, pasi që, siç është raportuar, ai ishte në komë si pasojë e të rrahurave në polici. Më 31 janar familja e tij zbuloi se ai ishte rrëmbyer nga spitali. Përkundër përpjekjeve të tyre për të marrë informacion nga policia rreth vendit ku ai ndodhej dhe mohimit të autoriteteve se kishin të bëjnë me rrëmbimin e tij, ai u rishfaq më 28 shkurt ku u vu përpara hetuesisë dhe u morr në pyetje në praninë e avokatit të tij mbrojtës. Avokati i tij me pas raportoi se klienti i kishte treguar se ishte marrur prej policisë dhe çuar në një vend të panjohur ku ishte lidhur në shtrat dhe torturuar me shok elektrik dhe ishte keqtrajtuar në mënyra të ndryshme me qëllim që ta deturojnë të nënshkruanq "pranimet" që e bënin atë fajtor.

Ata që u arrësuan mes tetorit 1996 dhe shkurti 1997 u paditën në tri grupe që erdhën në gjyq midis majit dhe dhjetorit 1997.

#### **Gjyqi i Avni Klinakut dhe 17 të tjerëve**

Në maj të vitit 1997 **Avni Klinaku**, 15 shqiptarë të tjerë enik dhe dy femra u dënuan me burg mes 2-10 vjetë. Dy burra të tjerë u dënuan në *mungesë* në të njëjtin gjyq. Akuzat kundër tyre ishin kombinime të ndryshme të Artikullit 136 të Kodit Federal Kriminal që përfshijnë "Bashkëveprim për qëllim aktiviteti

armiqësor", dhe në bazë të Artikullit 116 për "rezikimin e integritetit teritorial (të RF të Jugosllavisë)". Gjashtë prej tyre, përfshirë dhe vetë Avni Klinakun, u dënuan sipas Artikullit 125, për "terrorizëm". Ata u akuzuan ngase kanë formuar apo i përkasin një organizate klandestinë të quajtur Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), qëllimi i së cilës ishin përpjekjet e dhunshme për shkëputjen e krahinës së Kosovës dhe zonave tjera të banuara nga shqiptarë etnik, dhe formimi i një shteti të veçantë që do të bashkohej me Shqipërinë. Pesë veta u akuzuan se kishin planifikuar dhe përgatitur një sulm të armatosur kundër një patrulle policie dhe katër të tjerë u akuzuan për mbajtje të armëve. Të tjerët u akuzuan më tepër për prodhimin dhe shpërndarjen e gazetës së organizatës *Çlirimi* apo rekrutimin e anëtarëve në organizatë. Shumica e të mbrojturve mohuan se ishin të përzier me "terrorizëm" dhe 10 veta pohuan se nuk kishin bërë me shumë se shpërndarjes së gazetës *Çlirimi*. Pesë vetë mohuan se kishin qenë anëtarë të organizatës.

Në gjyq, njëmbëdhjetë të paditur dorëzuan deklaratat që tregonin se ata ishin torturuar ose keqtrajtuar gjatë hetimit dhe kishin dhënë deklaratat ndër presion. Sipas Fondit për të drejtën humanitare (FDH) në Beograd, i padituri **Emin Salahu** e përshkruan hollësisht se si ishte torturuar para se të jepte deklaratën: "një maskë gazi ishte vëndosur mbi fytyrën e tij, goja i'u mbush me letra dhe ai u rrah me shkopiinj elektrikë dhe të fortë në duar, kembë dhe në veshkë, si dhe u kercënua me përdorimin e

drogave”<sup>3</sup>. Në dokumentet e gjyqit, gjykatësi kishte shënuar se Emin Salahu “nuk donte të mbrohej pasi që deklarimet e tij . . . ishin pasojë e zbatimit të forcës, dhunës dhe kërcënimit që ishte kryer mbi të. Të paditurit tjerë në mënyrë të ngjashme, tërhoqën paditë e tyre në gjyq, megjithëse dokumentet gjyqësore regjistronë se vetëm tre prej tyre janë ankuar për tortura (psh. **Enver Dugolli** u ankua për torturë, por ankesa e tij nuk është regjistruar në dokumentat gjyqësore). Deklaratat e marra nën torturë gjatë periudhës fillestare të hetimit, u paraqitën dhe u pranuan nga gjykata si provat me të rëndësishme për ndjekjen penale.

Nje raport i Elisabet Ren-it, në atë kohë Raportuesja Speciale e Komisionit për të Drejtat e Njeriut të KB, përgjegjëse për RF të Jugosllavisë, i bazuar në vëzhgimet e terenit nga nëpunësit e saj gjatë kohës se gjykimet, zbulon shkelje të tjera të standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta<sup>4</sup>. Sipas disa avokatëve mbrojtës, dy anëtarë laik të trupit gjykues, të ishin ulur me gjykatësit, ishin oficerë të policisë të dale në pension, duke nënvlerësuar kështu pavarësinë dhe paanësinë e gjyqit. Ajo që duhet theksuar është se të akuzuarve i’u mohua mundësia i mjaftueshëm që u përgatiten për të mbrojtur veten. Avokatëve mbrojtës i’u mohua mundësia e aksesit në gati të gjitha dokumet relevante deri dy

<sup>3</sup> Komunikatë e FDH, *Priština court rules without evidence*, 2 qershor 1997

<sup>4</sup> *Two trials of Kosovo Albanians charged with offences against the State in the Federal Republic of Yugoslavia in 1997*, dokument i Komisarit të Lartë për të Drejtat të Njeriut të KB (E/CN. 4/1998/9).

javë para se të fillonte gjykimi. Përveç kesaj, sipas raportit të KB disa nga të akuzuarit arritën të kenë avokatë mbrojtës vetëm kur hynë në sallën e gjykatës ku u bë hapja e gjykimet. Ata që kishin avokatë mbrojtës para se të bëhej gjykimi, nuk kishin pasur mënyrë si të komunikojnë privatisht me ta pasi që përgjoheshin nga rojet. Kështu të akuzuarit nuk ishin të lirë as të ankoheshin tek avokatët e tyre për torturën dhe keqtrajtimin që kishin vuajtur.

Sipas FDH asnjë deshmitarë i ngjarjes nuk u paraqit (përveç ekzaminimit të vetë akuzuarve) dhe prova e vetme jo dokumentar ishte një mitraloz. Kur avokatët mbrojtës i kërkuan paditësit të paraqesë armët tjera që pretendonin se të akuzuarit i kishin, ata u përgjegjën se nuk kishin gjetur armë tjera dhe se armët tjera figuronin në “pohimet” e të akuzuarve. Megjithatë, paditësi i regjistroi ata sikur kishin pasur armë. Provat e dokumentuara, përveç statusit të LKÇK-së dhe kopjeve të gazetës *Çlirimi*, janë të përbera nga fotokopje dhe lista policore e gjërave të gjetura gjatë bastisjeve.

Edhe pse disa të akuzuar pranuan disa pjesë të akuzave si për shembull anëtarësinë në LKÇK dhe përgatitjen e shpërndarjen e *Çlirimit*, të tjerët e mohuan akuzën krejtësisht. Për shembull **Shukrije Rexha** ishte regjistruar në aktgjykim se kishte pohuar që tre artikuj të shkruar nga ajo ishin paraqitur në gazetën *Çlirimi*, porse ajo kishte patur shumë pak kontakt me botuesit dhe nuk kishte pasur kohë të njihej me natyrën e organizatës.

Brengosjet tjera rrjedhin edhe nga fakti se kaluan pothuajse tetë muaj në mes lëshimit të vendimit gjyqësor nga gjykata më 30 maj 1997, dhe marrjes së vendimit të shkruar prej avokatëve mbrojtës më 31

janar 1998. Megjithëse, në përputhje me standardet ndërkombëtare, gjykimi fillestar është mbajtur dhe përfunduar menjëherë, të akuzuarit u vonuan jashtë mase në mundësinë e tyre për të dorëzuar apelimet pasi që duhej të prisnin vlerësimin me shkrim. Asnjë hetim nuk dihet të jetë bërë përse i përket deklarimeve të akuzuarve që deklaratat e tyre janë nxjerrur me mjete torturose. Duke u mbështetur në çka u tha me lart dhe në probleme tjera për të cilat nuk ka vend ketu, Amnesty Interneshënëll beson që të akuzuarit në këtë rast nuk patën gjykim të drejtë dhe duhet tu jepet mundësia të rigjykojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

#### Gjyqi i Besim Rames dhe të tjerëve

Në qershor të vitit 1997 filloi gjykimi i një grupi të tjetër të përbërë prej 15 të akuzuarve. Nga të akuzuarit vetëm tre: **Besim Rama, Avni Nura dhe Idriz Asllani** ishin të pranishëm në gjykim, 12 të tjerët u gjykuan në mungesë. Të gjithëve i'u dha dënimi muajin tjetër dhe u dënuan nga katër deri 20 vjet burg. Një nga të dënuarit në mungesë ishte **Adem Jashari** (për fatin e mëtejshëm të të cilit shih dokumentin shoqëruar *Dhuna në Drenicë*, #2 në këtë seri, AI Index: EUR 70/33/98/ALB).

Ata u akuzuan në mënyra të ndryshme; për kryerje të përgatitjes ushtarake në Shqipëri dhe si anëtarë të UÇK-së, se kishin kryer një seri aktesh të dhunshme nga viti 1993 deri më 1996 përfshirë këtu sulme kundër patrullave të policisë ku ishin vrarë oficerë të policisë dhe sulme ndaj qendrave ku banonin refugjatët serb. Vëzhguesit e gjyimit që përshinë një delegat të Seksionit Suedez të Komisionit

Ndërkombëtar të Juristëve<sup>5</sup>, vuri re të njëjtat mungesa në lidhje me drejtësinë e gjykimeve sikur në gjykimin e Klinakut. Kishte shkelje të shumta të KPP-së dhe standardeve ndërkombëtare në procesin para gjyimit, sidomos mohimi i mundësisë për të patur mbrojtje të këshilluar dhe arrestimi ilegal i dy të akuzuarve për 16 ditë në shtator të vitit 1997. Gjatë gjyqimit të akuzuarit u ankuan se pohimet e tyre ishin marrë prej torturave dhe avokatët mbrojtës u ankuan se i'u është ndaluar mundësia e shikimit të dokumenteve të provave. Besim Rama tërhoqi të gjitha pohimet që kishte bërë gjatë hetimit dhe pranoi vetëm një pjesë të vogël të akuzave të ngritura kundër tij. Sipas gjyqimit, i cili nuk arriti të merret nga avokatët mbrojtës deri në shkurt të vitit 1998, gjyqi megjithatë i kushtoi rëndësi të madhe pohimeve të bëra nga të akuzuarit para gjyqimit, të cilat dukeshin se ishin pranuar si prova kyesore për fajin e tyre.

#### Gjykimi i Nait Hasanit dhe 6 të tjerëve.

Në Dhjetor të vitit 1997, grupi i tretë në krye me **Nait Hasanin**, u dënua për të njëjtat akuza si ato të gjyqimit të Besim Ramës. Dy të akuzuar të tjerë u gjykuan në mungesë dhe dy të tjerë vdiqën para gjyqimit; një prej të cilëve, **Jonuz Zeneli**, vdiç gjatë arrestimit. Amnesty Interneshënëll pati të njëjtat shqetësime rreth gjyqimit të tyre dhe shkeljeve të tjera

<sup>5</sup> Report to the Swedish Sedction of the Internwtional Commission of Jurists from Judge Bengt Bondeson and Public Prosecutor Sara Källberg, Stockholm, concerning observer assignments at the District Court in Priština, Yugoslavia on 3 - 6 June 1997.



të të drejtave të njeriut e sidomos lidhur me arrestimin e paditur të **Nait Hasanit** për një muaj në shkurt të vitit 1997 (shihni me lart).

Amnesti Interneshënëll është e brengosur gjithashtu për sigurinë e avokatëve mbrojtës në këtë gjykim pas sulmit ndaj njërit prej avokatëve Hasan Hotit nga tre persona të paidentifikuar të armatosur që mendohej të ishin serbe në nëntor të vitit 1997.

Akoma deri tani, qershor 1998, nuk është lëshuar dokumenti me shkrim i gjykimit.

### **Gjykimet e padrejta në vitin 1998**

#### **Gjykimi i Mehmet Memçaj dhe tre të tjerëve në Prizren, në maj të vitit 1998**

Më 27 maj 1998 pesë burra, i pari i quajtur **Mehmet Memçaj**, prej të cilëve njëri në *mungesë*, u dënuan nga Gjykata e Prizrenit, me tre deri në shtatë vjet burg. Këta burra u arrestuan rrëth dhe në Prizren mes 27 dhe 28 shkurtit 1998. Policia njoftoi emrat e katër prej tyre dhe të një personi tjetër që u lirua me vonë, se ishin arrestuar “për shkak të sulmeve terroriste të 28 shkurtit dhe 1 marsit 1998”, duke ju referuar incidenteve në Likoshan dhe Qirez gjatë atyre ditëve (shihni dokumëntin shoqërues *Dhuna në Drënicë*, #2 të kësaj serie AI Index: EUR 70/33/98/ALB). Akt padia e mëtejshme nuk kishte asnjë lidhje me incidentet e Likoshanit por i akuzonte ata për vendosjen e një bombe në Prizren (që me sa duket nuk arriti të shpërrthente), për mbajtje dhe kontrabandë armësh dhe për të qenurit anëtarë të një organizate të quajtur Lëvizja Kombëtare për Republikën e Kosovës. Avokatët e tyre u ankuan pasi që ata nuk

ishin lejuar të kishin kontakt me klientet e tyre deri më 3 mars dhe akoma nuk kishin mundësi të flisnin privatisht me ta. Të arrestuarit u ankuan gjithashtu se kishin qenë subjekt i torturave të policisë me shkopinj shoku elektrik në mënyrë që të nxirrnin prej tyre “pohime”, edhe pse ata nuk mundën të zbulonin të gjitha detajet për shkak të prezencës se rojeve gjatë vizitave të avokatëve. Ata vazhduan të ankoheshin se policia kishte vazhduar t’i torturoj dhe interigojë edhe kur ata u vunë nën kujdestarinë e gjykatësit të hetuesisë për shkak të pohimeve “jo të plota” që ata ju dhanë gjykatësve hetues. Amnesti Interneshënëll ka akoma hollësi për të mbledhur, por beson që ekzistojnë indikatorë të fuqishëm që të fusin të dyshosh në gjykim të drejtë

Së paku 12 shqiptarë të tjerë, jo me vonë se maji i 1998, ishin të arrestuar për arsye të njejtë politike ku disa prej të cilëve i kanë akt paditë gati. Amnesti Interneshënëll është duke kërkuar detale për keta të arrestuar duke pasur frikë se ata gjithashtu janë torturuar apo keqtrajtuar gjatë arrestimeve dhe do të ndeshen me gjykime të padrejta.

### **Rekomandimet e Amnesti interneshënëll**

#### **Autoriteteve Serbe dhe Jugosllave.**

- Autoritetet duhet të ndërmarrin masa që të sigurojnë se standardet adekuate ruhen gjatë përdorimit të armës policore dhe gjatë zbatimit të drejtësisë. Vëmëndje e veçantë duhet t’i kushtohet dhënies fund të keqtrajtimit apo torturës se rasteve që janë nën mbikqyrjen e policisë. Si hap i parë me

rëndësi, ata duhet të aplikojnë në praktikë të drejtën e të akuzuarit që të mirret në pyetje në prezencë të avokatit mbrojtës në zgjedhjen e tij/asaj, bazuar në Artikullin 29 të Kushtetutës së RFJ dhe Artikullit 24 të Kushtetutës së Sërbisë. Parimet e Procedurës Kriminale duhet të vihen në harmoni me Kushtutetën dhe standarde ndërkombëtare të drejtave të njeriut sa më shpejtë që është e mundur.

- Autoritetet duhet të marrin hapa të ardhshëm të sigurojnë që të akuzuarve në gjykime politike t'u mundësohet gjykim i drejtë. Kjo do të duhej të nënkuptonte të drejtën e të akuzuarve që të komunikojnë privatisht me përfaqësuesit legal të tij/saj në të gjitha fazat e procesit ligjor.

- Autoritetet duhet të sigurojnë që deklaratat të nxjerrura me mjete dhune nuk duhet të përdoren si dëshmi në gjykime dhe në të gjitha rastet akuzat që të akuzuarit janë torturuar dhe keqtrajtuar të hetohen me kohë dhe përgjegjësit duhet të japin llogari.

- Autoritetet duhet të sigurojnë që procedurat dhe hetimet e krimeve të fillojnë të vënë para përgjegjesisë çdo oficer të zbatimit të ligjit të dyshimtë për dhënien e urdhërave apo për mundësimin e shkeljes së drejtave të njeriut.

- Autoritetet duhet të sigurohen që të gjithë anëtarët e forcave të sigurimit që kryejnë funksione të zbatimit të ligjit në krahinën e Kosovës janë të njoftuar dhe me këtë janë të ushtruar t'i aplikojnë standardet vijuese ndërkombëtare:

- ◆ Parimi i KB për Përdorimin e Zyrtarëve të Zbatimit të Ligjit.
- ◆ Parimi i KB për Mbrojtjen e Gjithë

Personave që gjenden në çfarëdo Forme Arresti apo Burgosjeje.

- Autoritetet duhet të lejojnë hapjen e një zyreje tereni të Zyres së Komisarit të Lartë për të Drejta të Njeriut të KB (OHCHR) të cilën Komisari i Lartë e ka kërkuar në Prishtinë.

- Autoritetet duhet të lejojnë një mision të zgjeruar të përkohshëm të vëzhgimit të drejtave të njeriut të OHCHR-së siç rekomandohet në një letër të Raportuesit Special mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut në Teritorin e ish -Jugosllavisë, Jiri Dienstbier, për Komisionin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të datës 14 prill 1998.

- Autoritetet duhet të japin leje për rivendosjen e Misionit Afatgjatë të Organizatës për Sigurim dhe Bashkpunim në Evropë.

#### **Të gjitha qeverive që marrin pjesë në Kombet e Bashkuara**

- Keto qeveri duhet të sigurojnë që zyret në teren të ZKLDN-së në Jugosllavi janë të pajisura ashtu siç duhet në menyrë që të plotësojnë kërkesat që bëhen ndaj tyre.